**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DURRËS**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**
**SEKTORI I PROKURIMEVE**

**Durrës, më 30.10.2024**

**PROCESVERBAL**
**Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT**: "Ndërtim shkolla 9-vjeçare Vadardh, Sukth"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV**:** Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare 45214220-8

Në mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimit Nr.225, datë 12.04.2021 "Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit", të ndryshuar;
Për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentet standarde "Procedurë e përshpejtuar – rindërtimi punë", lloji i procedurës "Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

*Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrit te Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumente.*

*Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.*

**VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL**: 268.788.521,53 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e një presje pesëdhjetë e tre) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, sipas grafikut të punimeve.

 Njësia Administrative Nr.1, Lagjja 3, Sheshi "Liria", Nd.1, tel & fax +355 52 2/223 10, web: www.durres.gov.al/ e- mail: info@durres.gov.al

Garancia për mbulimin e difekteve, që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

**Argumentim:**

MBI PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT:
"Ndërtim shkolla 9-vjeçare Vadardh, Sukth"

Në zbatim të urdhrit të grupit te Specifikimeve nr.205, datë 26.06.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Vendimin të Këshillit të Bashkiak nr.195, datë 22.12.2023, "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2024", si dhe në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr.114, datë 16.04.2024.
2. Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga studio projektimit "NET-GROUP" sh.p.k dhe oponencën teknike.

**PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**:
Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:
Specifikimet teknike të hartuara nga studio projektimit "NET-GROUP" sh.p.k dhe të miratuara nëpërmjet oponencave teknike në institutin e ndërtimit.
*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr.162 , datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".*

**PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS**
Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar sipas të cilit: Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a) çmimet e tregut; ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: "Ndërtim shkolla 9-vjeçare Vadardh, Sukth ", të hartuar nga studio projektimit "NET-GROUP" sh.p.k.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e hartuar nga studio projektimit, ku jane mbeshtetur dhe njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht ne manualin nr.216 datë.13.04.2023, për "Miratimi i çmimeve" si dhe për disa zëra ne çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se:
Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull:“Ndërtim shkolla 9-vjeçare Vadardh, Sukth”, rezultoi të jetë me vlerë: 268.788.521,53 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e një presje pesëdhjetë e tre) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Garancia për mbulimin e difekteve, që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur, referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga projektuesi, ku janë mbështetur dhe strukturat e posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**
a. Përshkrimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;
b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas *Shtojcës 4;*
c. Sigurim oferte sipas *Shtojcës 5*;
ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas *Shtojcës 7*;
d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, *sipas Shtojcës 8*;
dh.Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës *Shtojcës 11*;
e. Formular vlerësimi sipas *Shtojcës 12*;
f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas *Shtojcës 13*;
g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas *Shtojcës 14*;
gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

**Argumentimi**: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**
**2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**
Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, *sipas shtojcës 10*.

**Argumentimi**: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 268.000.000 lek.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndyshuar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*
*Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.*
*Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*
*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*
*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" i ndrzshuar: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar".*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
*Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë ketë dokument).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*
*Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara te kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

**2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**
**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:
- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 134.000.000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 536.000.000 Lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:
a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 12.*
b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:
**Argumentimi***: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar referuar fondit limit, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

**Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë jan**ë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik":

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi:
- N.P – 1 B Punime gërmimi në tokë;
- N.P – 2 C Ndërtime civile e industriale;
- N.P – 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje
- N.P– 12 A Punime te inxhinierisë së mjedisit

Punime Speciale Ndërtimi:
- N.S. – 1A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 2A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S – 3A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkalle lëvizëse, transportues)
- N.S – 4C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues;
- N.S – 9A Punime strukturore speciale
- N.S – 12A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S – 14A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- NS – 18A Punime topogjeodezike
- NS – 20B Shpime gjeologo-inxhinierike,

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente te kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne këtë forme është kusht skualifikues.*

**Argumentimi**: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.*
*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.*

**Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve**

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|---|---|---|---|---|
| NP 1 | Punime germimi ne toke | Shpim me sonda "UKS" Ø 0.8 m, ~ 25 m (h=5m)<br>Shpim me sonda "UKS" Ø 0.8 m, ~ 25 m (h=10.1m)<br>Germim cakulli I bazamentit te sondes, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto<br>Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategoria III, h = 1.5 m<br>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri, per sonden (3 shtresa vendosur siper njera tjetres per te krijuar lartesin t=60cm)<br>Germim dheu pilotat, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto<br>Germim trau I pilotave, per pllaken dhe traret e themelit te shkalles se emergjences, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto | B<br>(21- 50 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 21,519,809 lek |
| NP 2 | Ndërtime civile e industriale; | Shtrese betoni C 12/15 nen pllaken e themelit dhe nen shkallen e emergjences,Themel e xokol butobetoni C - 12/15, Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30, F.V. waterstop ekspansiv (2x2.5 cm), FV konstruksione metalike te perbera (shkallet e emergjences), Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m | C<br>(51-100 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 72,266,131 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Soleta te plota b/a C 25/30 t = 10 cm, h ~ 4m me kristaline<br>Mure b/a C 30/37 h ~ 4m me kristaline<br>Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 shkallet e emrgjences<br>Trare themeli b/a C25/30 h ~ 4m (shkalla metalike)<br>Trare e arkitrare b/a C25/30 me kristaline<br>Trare e arkitrare b/a C30/37 h ~ 4m<br>Trare e arkitrare b/a C35/45 h ~ 4m<br>Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 25/30 me kristaline<br>Soleta te plota b/a C 30/37 t = 10 cm, h ~ 4m (shkalla)<br>Soleta te plota b/a C 30/37, h ~ 4m<br>Soleta b/a me traveta dhe me tulla C 30/37 t = 30 cm, hd=6 m<br>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm<br>F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm | | |
| NP-7 | Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës , vepra kullimi dhe vaditje | F.V Tuba ujesjellesi PE d=50mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Fashete PE me EF Red. DJ 90/DJ 50 PN 16<br>F.V Rakorderi Brryl PE me EF DJ 50 PN 16, F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=125 mm, Ndertim puseta betoni H=4m, D=1.5m + kapak gize<br>Ndertim puseta betoni H=4m, 100x100 + 60x60 + kapak gize<br>"F.V. Pompe zhytese per pompimin e ujrave te zeza e pajisur me panel kontrolli, galexhant dhe aksesore per funksionim normal<br>-Prurja Q=11 l/sek<br>-Prevalenca H=11.5mkH2O<br>-Fuqia elektrike 2x1.3kW<br>-Rryma 2x6.1A<br>-Ushqimi 3F~380-415V/50Hz<br>-Lidhja ne thithje DN 65 PN10<br>-Shkalla e mbrojtjes IP 68"<br>"F.V. Pompe zhytese per pompimin e ujrave te zeza e pajisur me panel kontrolli, galexhant dhe aksesore per funksionim normal<br>-Prurja Q=2 l/sek<br>-Prevalenca H=7.5mkH2O<br>-Fuqia elektrike 2x1.3kW<br>-Rryma 2x6.1A<br>-Ushqimi 3F~380-415V/50Hz | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 8,337,350 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Lidhja ne thithje DN 65 PN10<br>-Shkalla e mbrojtjes IP 68"<br>F.V Tuba PE d=63mm, PN 20<br>F.V Rakorderi Bashkues PE DJ 63 PN 20, F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm, Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, F V tuba drenazhi HDPE te brinjezuar d=160mm<br>Puse kontrolli 1x1x1.5m<br>"F.V Pompe drenazhi zhytese per pompimin e ujrave te bardha e pajisur me panel kontrolli, galexhant dhe aksesore per funksionim normal<br>- Prurja: 10 l/sec,<br>-Prevalenca H=10mkH2O<br>- Fuqia elektrike 1.1kW<br>- Rryma 6.1A<br>- Ushqimi 3F~400V/50Hz<br>- Lidhja ne thithje 2 1/2""(63x7.1) PN10<br>- Shkalla e mbrojtjes IP 68"<br>F.V Tuba PE d=50mm, PN 20 | | |
| NP-12 | Punime te inxhineris se mjedisit | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km, Mbjellje bari ne skarpat, F.V. Fidane Peme dekorative, F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar (cdo 6m)<br>FV Reklama te printuara me ngjyra ne adeziv pergjate rrethimit ballor ne hyrje te kantierit<br>Rrethimi I objektit me llamarine h=2m,<br>F.V. kabinë metalike për drejtuesit e kanierit e papërshkueshme nga uji, e pajisur me ngrohje dhe energji elektrike, me dritare e derë të sigurta për pajisjet e brendshme.<br>F.V kabina portative tualeti | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 4,032,904 lek |
| NS–1 | Punime per prishjen e ndertimeve. | Prishje mure beton/arme (për brezin udhëzues) | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 418,372 lek |
| NS-2 | Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre. | F.V Tuba ujesjellesi PPR D = 50 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Brryl PPR D = 50 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø50 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø50/Ø40/Ø50 mm Pn 16 | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 6,264,417 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | F.V Rakorderi Ti PPR Ø50/Ø32/Ø50 mm Pn 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PPR d=40mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Brryl PPR D = 40 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø40/Ø32/Ø40 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø40/Ø20/Ø40 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Reduksion PPR Ø40/Ø32 mm Pn 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PPR d=32mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Brryl PPR D = 32 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø32 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø32/Ø25/Ø32 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø32/Ø20/Ø32 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Reduksion PPR Ø32/Ø25 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Reduksion PPR Ø32/Ø20 mm Pn 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PPR d=25mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Brryl PPR D = 25 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø25 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Ti PPR Ø25/Ø20/Ø25 mm Pn 16<br>F.V Rakorderi Reduksion PPR Ø25/Ø20 mm Pn 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PPR d=20mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Brryl PPR D = 20 mm Pn 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PEX-AL d=20mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Bashkues ujesjellesi PEX-AL d=20mm, PN 16<br>F.V Tuba ujesjellesi PEX-AL d=16 mm, PN 16<br>F.V Rakorderi Bashkues ujesjellesi PEX-AL d=16mm, PN 16<br>Termoizolim tubi Ø 1/2" me armofleks (d22x9) | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)<br>Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)<br>Termoizolim tubi Ø 11/4" me armofleks (d42x9)<br>Termoizolim tubi Ø 11/2" me armofleks (d54x9)<br>Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)<br>F V rezervuari zingato 5000 litra<br>F.V Saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm<br>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm<br>F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm<br>F.V Valvul moskthimi bronzi Ø 2" = 50 mm<br>F.V Filter bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Ajrues Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Aparat ujemates bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Kasete metalike 35x45<br>F.V lavaman porcelani importi me mishelator<br>F.V WC allafrenga importi<br>F.V Pllak dushi + Grup<br>F.V lavapjate importi me llamarine xingat<br>F.V Tub flexibel Ø 1/2 "<br>"F.V Grup pompimi me shpetesi variabel (inverter) per furnizimin e ujit sanitar, me dy pompa me karakteristikat Teknike:<br>Prurja: 5.8 m³/h<br>Prevalenca: 28 mkH2O<br>Lidhjet: Ø 2"" / PN 16<br>Fuqia e instaluar: 1.1kW,<br>Intensiteti i rrymës: 8.1 A,<br>Tensioni i dhenë: 3 x 380-415 V/50Hz<br>E kompletuar me te gjithe aksesoret e nevojshem, kolektor lidhjeje, ene zgjerimi, panel elektrik, valvol mbipresioni, valvol moskthimi, ene zgjerimi etj."<br>F V bolier 80 liter, uje te ngrohte<br>F V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar<br>F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 2+1 )<br>F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 3+3 )<br>F.V Kolektor shpendares 1"( 6+3 )<br>F.V Kolektor shpendares 1"( 6+6 ), F.V | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Tub shkarkimi HT(PP) gri me gota dhe gomina Ø 125 mm<br>F.V Tub shkarkimi HT(PP) gri me gota dhe gomina Ø 110 mm<br>F.V Tub shkarkimi HT(PP) gri me gota dhe gomina Ø 75 mm<br>F.V Tub shkarkimi HT(PP) gri me gota dhe gomina Ø 50 mm<br>F.V Bryla HT(PP) Ø 125 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Bryla HT(PP) Ø 110 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Bryla HT(PP) Ø 75 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Bryla HT(PP) Ø 50 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Reduksion HT(PP) Ø 125/110<br>F.V Reduksion HT(PP) Ø 110/50<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 125/125<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 125/110<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 110/110<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 110/75<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 110/50<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 75/75<br>F.V Brag HT(PP) 87.5/67.5/45° Ø 50/50<br>F.V Tape Kontrolli HT(PP) Ø 110<br>F.V Fasheta metalike me seksion rrethor dhe gomina elastomere per mberthimin e tubave<br>F.V Kapuç ajrimi ne tarrace vertikal Ø 110mm<br>F.V pilete dyshemeje Ø 50 mm, F.V Pileta tarrace PE/ABS me kapak tip rrjete konike 110<br>F.V Tub shkarkimi HT(PP) me gota dhe gomina Ø 110 mm<br>F.V Bryla HT(PP) Ø 110 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Kunete e mbledhjes se ujit te shiut, me zgare metalike per mbulim<br>Puseta Kontrolli shiu | | |
| NS-3 | Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, | F.V ashensor | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shkallë lëvizëse, transportues). | | | |
| NS-4 | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. | Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-15 t=20 cm (perimetral dhe brenda)<br>Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 (brenda+oxhaqet)<br>Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m (oxhaqet)<br>Struktura monolite betoni C 20/25 (kapaket e oxhakut)<br>F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm (oxhaqet)<br>Trare e arkitrare b/a C25/30 h ~ 4m (arkitrare)<br>Breza b/a monolit C 20/25<br>Termozolim me lesh guri, 5 cm (ʎ=0.037w/m.k, R=1.35 m2.K/W) (muret)<br>Patinim tavani allçi (stuko)<br>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (arkitratet dhe brezat)<br>F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm (arkitratet dhe brezat), Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum (bazamenti i objektit+ bazamenti I shkalleve te emergjences), Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 duar k.katrama<br>F.V Protefon per mbrojtje hidroizolimi ne bodrume<br>Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm (muret e katit nentoke), Boje vaji siperfaqe metalik (shkallet e emergjences), Shtrese avull izoluese gjeotekstil<br>Shtrese me stirobeton (t=10 cm )<br>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 duar k.katrama<br>Shtrese termoizoluese me polisterol t=5 cm<br>Shtrese lluster cimento 1:2 t=3 cm<br>Shtrese me pllaka granili me boje, 30x30cm (taraca dhe taraca e palestres), Shtrese me stirobeton 3 cm<br>Shtrese lluster cimento 1:2 t=2 cm<br>Shtrese me pllaka mermeri t=3cm (shkalle)<br>Shtrese me pllaka mermeri t=2 cm (davancale dritare+parapet tarace) | C<br>(51 – 100 milion lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 87,938,804 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Shtrese me pllaka grez porcelanato<br>Shtrese parketi laminat<br>Plintuse pllake grez<br>Plintuse mermeri h = 10cm<br>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me pompe<br>Tavan me kartonxhes<br>Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25<br>Veshje me pllake majolike<br>Hidroizolim me dy shtresa mapej (tualete)<br>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva., F V dritare d/alumini plastike me dopio xham<br>F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham<br>F.v dyer te brendeshme tamburate te rimesuara<br>F.V Dyer te blinduara kunder zjarrit<br>Dyer te blinduara importi, Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (jashte), Bordura betoni 6x20 cm<br>Struktura monolite betoni C 16/20 nen bordure t= 10 cm (0.025 m3/ml)<br>Shkalle montazhi mermeri t= 3 cm<br>F V konstruksione metalike te perbera Shkallet brenda dhe jashte+ parmake muri rrethues<br>Boje vaji siperfaqe metalik parmake shkalle, parmake muri rrethues, Shtrese betoni C 12/15 nen themelin e murit rrethues<br>Nenshtrese zhavori t=10 cm<br>Struktura monolite betoni C 20/25 (per murin rrethues l=62 ml)<br>Mur me tulle plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 15 (muri rrethues)<br>Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m (muri rrethues)<br>Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (muri rrethues)<br>Breza dhe kolloncina b/a monolit C 20/25 ne murin rrethues<br>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (per murin rrethues)<br>F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm (per murin rrethues)<br>Struktura monolite betoni C 16/20 ne | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | trotuar t= 10 cm<br>Shtrese rere natyrore t=10cm (nen pllaka trotuar)<br>Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm (trotuar)<br>Struktura monolite betoni C 20/25 (per stolat)<br>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (per stolat)<br>Pergatitje e vendosje lende e sharruar (mbulese druri per stolat)<br>Boje vaji siperfaqe druri | | |
| NS-9 | Punime strukturore speciale | F.V palankola metalike ( h=12 m)<br>Ngulje dhe shkulje palankola metalike<br>Struktura monolite betoni C 25/30 (për pilotat)<br>Struktura monolite betoni C 25/30 (për traun e Pilotave)<br>Struktura monolite betoni C 20/25 (për pilotat e betonit)<br>F.V hekur betoni periodik Ø6-10 mm (per pilotat)<br>F.V hekur betoni periodik Ø>10 mm (për pilotat)<br>Prishje mure beton/arme (për brezin udhëzues) | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 17,139,024 lek |
| NS-12 | Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit | "F.V Grup pompimi i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit ne perputhje me standartin SSH EN 12845:2015<br>Motopompe me lende djegese Diesel, ftohje me ajer, injektim te drejtperdrejt te lendes djegese.<br>Motor Pompe me Diesel<br>- Prurja: 360 l / min<br>- Prevalenca: 3.8 bar<br>- Fuqia 7.5kW<br>Pompe Elektrike<br>- Prurja: 360 l / min<br>- Prevalenca: 3.8 bar<br>- Fuqia: 7.2 kW<br>- Rryma: 3 x 400 V<br>- Tensioni: 5.6 A<br>- Shkalla e mbrojtjes: IP 54<br>Pompa Pilot<br>- Fuqia: 1.1 kW<br>- Rryma: 1.8 A | A<br>(0- 20 milionë lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 19,747,493 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | - Kolektori ne thithje DN50 PN16<br>E kompletuar me te gjithe aksesoret e nevojshem, kolektor lidhjeje, ene zgjerimi, panel elektrik, valvol mbipresioni, valvol moskthimi, ene zgjerimi etj."<br>F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Tuba celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit 2"<br>F.V Rakorderi Brryl celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit Ø2"<br>F.V Rakorderi Ti celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit Ø2"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit Ø2"/Ø1 1/2"<br>F.V Tuba celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit 1 1/2"<br>F.V Rakorderi Brryl celik i zi, i lyer me boje antiruxho kundra korozionit Ø1 1/2"<br>F.V Elemente mberthyes e fiksues<br>F.V Fikse zjarri me pluhur, destinacioni edhe per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 6 kg.<br>F.V Hidrante Zjarri Ø 11/2 ", L = 30 m<br>F.V Kasete hidranti<br>F.V Grup saraçineske me 1 gryke lidhje hidranti 11/2" për brigadat MNZ, F.V Tabela Hidrant Zjarri i (AL-52121-B)<br>F.V Tabela Fikese zjarri me pluhur dhe CO2 (AL-5203-B)<br>F.V Tabela Drejtim dalje emergjence (AL-5107-B)<br>F.V Tabela Zbritje, ngjitje, shkallesh (AL-5103-B), F.V Tuba celik, pa tegel 3"<br>F.V Rakorderi Brryl celik, pa tegel 3"<br>F.V Rakorderi Ti celik, pa tegel 3"<br>F.V Tuba celik, pa tegel 2 1/2"<br>F.V Rakorderi Brryl celik, pa tegel 2 1/2"<br>F.V Rakorderi Ti celik, pa tegel 2 1/2"/2 1/2"/2 1/2"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik, pa tegel 2 1/2"/2 "<br>F.V Tuba celik, pa tegel 2"<br>F.V Rakorderi Ti celik, pa tegel 2"/2"/2"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik, pa tegel | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2"/1 1/2"<br>F.V Tuba celik, pa tegel 1 1/2"<br>F.V Rakorderi Ti celik, pa tegel 1 1/2"/1 1/2"/1 1/2"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik, pa tegel 1 1/2"/1 1/4"<br>F.V Tuba celik, pa tegel 1 1/4"<br>F.V Rakorderi Brryl celik, pa tegel 1 1/4"<br>F.V Rakorderi Ti celik, pa tegel 1 1/4"/1 1/4"/1 1/4"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik, pa tegel 1 1/4"/1"<br>F.V Tuba celik, pa tegel 1"<br>F.V Rakorderi Brryl celik, pa tegel 1"<br>F.V Rakorderi Reduksion celik, pa tegel 1"/ 3/4"<br>F.V Tuba celik, pa tegel 3/4"<br>F.V Rakorderi Brryl celik, pa tegel 3/4"<br>Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)<br>Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)<br>Termoizolim tubi Ø 11/4" me armofleks (d42x9)<br>Termoizolim tubi Ø 11/2" me armofleks (d54x9)<br>Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)<br>Termoizolim tubi Ø 21/2" me armofleks (d76x9)<br>F.V saracineska bronzi Ø 2 1/2 " = 70 mm<br>F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm<br>F.V Filter bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Valvul moskthimi bronzi Ø 2" = 50 mm<br>F.V. Xhunto antivibruese, Ø 2 " = 50 mm<br>F.V. Preostat presioni<br>F.V. Reduktues Presioni Ø 2 " = 50 mm<br>F.V. Manometer presioni Ø 2 " = 50 mm<br>F.V. Valvol tre rrugeshe Ø 2 " = 50 mm<br>F.V Valvul sigurie 1/2" P=3 bar<br>F.V Valvul ajernxjerresi 1/2"<br>F.V reduktor presioni 0-6 bar(1/2"-1")<br>F.V Tuba PEX/AL/PEX DN 3/4 ( 20x2.2) i patermoizoluar<br>F.V Tuba PEX/AL/PEX DN 2" ( 32x3.2) i patermoizoluar | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | F.V Element radiatori alumin, kapaciteti ne ngrohje per cdo element 141 W, interaksi 600mm, ΔT=50 °C.<br>F.V Aeroterma per palestren me kapacitet ngrohes Q=8500 wat<br>F.V Kolektor shpendares 2" ( 3+3 )<br>F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 4+4 )<br>F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 5+5 )<br>F.V Kolektor shpendares 1" ( 6+6 )<br>F.V Kolektor shpendares 1" ( 7+7 )<br>F.V Kolektor shpendares 1 1/4" ( 8+8 )<br>F.V Kolektor shpendares 1 1/2" ( 10+10 )<br>F.V Ventil manometer bronxi 1/4"per gaz<br>F.V Termometer 1/4"<br>F.V Oxhak Inoks me dy shtresa D 300mm<br>"F.V Kaldaje me Pelete me karakteristikat Teknike:<br>-fuqia kalorike : 300 kW,<br>-dimension tubi dërgim/kthim : Ø 3""<br>-dimensioni i kanalit të tymit :Ø 300 mm"<br>"F.V Pompe qarkullimi me karakteristikat Teknike:<br>-Prurja: 20 m³ / h<br>-Prevalenca: 7 mkH2O<br>-Fuqia elektrike (2x0.6)<br>kW 1 F/230V/50Hz 2.65A<br>- Lidhjet: Ø 2"" /PN 16"<br>"F.V Ndares Hidraulik me karakteristikat Teknike:<br>-Prurja max : 10 m3/h<br>-Lidhjet Ø 1"""<br>"F.V Ene zgjerimit me karakteristikat teknike:<br>-Ene zgjerimi me membranë<br>-Presioni min /max: 9 bar,<br>-Temperatura max e punes 99 °C<br>-Kapaciteti 50 lit"<br>"F.V Ena e zgjerimit me karakteristikat teknike:<br>-Ene zgjerimi me membranë<br>-Presioni min /max: 9 bar,<br>-Temperatura max e punes 99 °C<br>-Kapaciteti 100 lit"<br>F.V. tuba teknologjike CrNi te furrave dhe CrMo te kolektoreve<br>"F.V Pompe qarkullim me karakteristikat Teknike:<br>-Prurja: 4 m³ / h | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Prevalenca: 7 mkH2O<br>-Fuqia elektrike (2x0.6)<br>kW 1 F/230V/50Hz 2.65A<br>- Lidhjet: Ø 2"" /PN 16"<br>"F.V Pompe qarkullimi me karakteristikat Teknike:<br>-Prurja: 4 m³ / h<br>-Prevalenca: 15 mkH2O<br>-Fuqia elektrike (2x0.6)<br>kW 1 F/230V/50Hz 2.65A<br>- Lidhjet: Ø 2"" /PN 16", F.V Tub pvc Ø 110 mm<br>F.V Bryla PVC Ø 110 α = 87.5/67.5/45/30/15º<br>F.V Brag PVC 87.5/67.5/45° Ø 110<br>"F.V Aspirator tualeti me karakteristika teknike:<br>-Kapaciteti thithës: 100 m³/h<br>-Tipi: Aspirator muri<br>-Numri i rrotullimeve në minutë: 1000 rpm<br>-Tensioni: 220-240 V / 50-60 Hz<br>-Fuqia: 40 W<br>-Diametri i tubit: Ø110 mm"<br>F.V Valvul aspiratori, Ø100 mm<br>F.V Fasheta metalike me seksion rrethor dhe gomina elastomere per mberthimin e tubave Ø 110 mm<br>F.V Kapuç ajrimi ne tarrace vertikal Ø 110 mm | | |
| NS-14 | Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. | F.V Përcjellës 1mm²<br>F.V Përcjellës 1.5mm²<br>F.V Përcjellës 2.5mm²<br>F.V Përcjellës Bakri 50mm² I zhveshur<br>F.V Përcjellës 10mm²<br>F.V Elektroda tokëzimi tipi L 1.5m t=3mm<br>F.V Kabëll 5x10mm²<br>F.V Tubë korogato f20<br>F.V Tubë korogato f25<br>F.V Tubë korogato f50<br>F.V Kabëll telefonie 4x0.5mm²<br>F.V Kabëll UTP CAT5e<br>F.V Kaset metalike 90 pozicionesh<br>F.V Rele diferencial 20A 30mA 4P<br>F.V Automatë A 6A<br>F.V Automatë C 50A 4P 6kA<br>F.V Automatë C 16A 4P 4kA | A<br>(0- 20 milion lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 2,839,984 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | F.V Automatë C 10A 4P 4kA<br>F.V Automatë C 16A 2P 4kA<br>F.V Automatë C 10A 2P 4Ka<br>F.V Automatë C 6A 2P 4Ka<br>F.V Priza Suko 16A<br>F.V Priza Telefonie<br>F.V Priza Interneti<br>F.V Llamp sinializimi të tensionit 3f<br>F.V Çelës 10A<br>F.V Çelës Deviat 10A<br>F.V kuti + suport + pllak 2 vëndesh<br>F.V kuti + suport + pllak 2 vëndesh jashtë murrit<br>F.V Morset inoksi<br>F.V Kuti shpërndarës PT3 10x10x7 cm<br>F.V Kuti shpërndarës PT5 15x15x7 cm<br>F.V Ndricues Led 1000 Lumen<br>F.V Ndricues Led 1500 Lumen<br>F.V Ndricues Led 2000 Lumen<br>F.V Ndricues Led 2500 Lumen<br>F.V Ndricues Led 3000 Lumen<br>F.V Ndricues Led 4000 Lumen<br>F.V Ndricues Led 5000 Lumen<br>F.V Ndricues Led 11000 Lumen Projektor<br>F.V Ndricues Evakuimi<br>F.V Ndriçues Dalje EXIT<br>F.V Spot inoksi me hyrje dalje të linjes për dhe' me Ndricues Led 1300 Lumen IP65<br>F.V Panel Sinjalizimi të zjarrit<br>F.V Buton emergjence<br>F.V Siren Alarmi<br>F.V Rufepritës<br>FV Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 | | |
| NS 18 | Punime topogjeodezike | Punime matje volume dhe piketimi te objektit, etj | A<br>(0- 20 milion lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar |
| NS 20 | Shpime gjeologo-inxhinierike, | Germim cakulli I bazamentit te sondes, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto<br>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri, per sonden (3 shtresa vendosur siper njera tjetres per te krijuar lartesin t=60cm)<br>Germim dheu pilotat, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto | B<br>(21- 50 milion lek) | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar 21,563,893 lek |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Struktura monolite betoni C 20/25 (për brezin udhëzues)<br>F.V palankola metalike ( h=12 m)<br>Ngulje dhe shkulje palankola metalike<br>Shpim me sonda "UKS" Ø 0.8 m, ~ 25 m (h=5m)<br>Shpim me sonda "UKS" Ø 0.8 m, ~ 25 m (h=10.1m) | | |

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

a. Inxhinier Ndërtimi (Profil Strukturist) 1 (një)
b. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
c. Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)
d. Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
e. Inxhinier Mekanik 1 (një)
f. Inxhinier Elektrik 1 (një)
g. Arkitekt 1 (një)
h. Inxhinier Gjeolog 1 (një)
i. Inxhinier Mjedisi 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune.*
*-Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.*
*-Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".*
*Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.*

**Argumentimi***: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "c".*
*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës*

*për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

*Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.*

*Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohet se: "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit" dhe pika 2: "elementët e licensës" gërma "c" ku citohet se: "Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë".*

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

a. Inxhinier Gjeoteknik 1 (një)
b. Inxhinier Elektronik 1 (një)
c. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 2 (dy) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin ne punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.
d. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Certifikatë për Auditim Energjie në ndërtesa", lëshuar nga institucione te njohura nga Republika e Shqipërisë, te cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.
e. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert zjarrfikës" ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate , te cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

f. Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka të punësuar 1 (një) inxhinier të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
   Për këtë duhet të paraqesë diplomë dhe certifikatën për vlerësimin e ndikimit në Mjedis të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

**Argumentimi**: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
*Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr.629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" bazuar ne perllogaritjen e oreve te punes, kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
Punonjes Staf Teknik

| | | |
|---|---|---|
| a. | Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
| b. | Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit | 1(një) |
| c. | Hidraulikë | 2 (dy) |
| d. | Elektricistë | 2 (dy) |
| e. | Karpentier | 3 (tre) |
| f. | Hekurkthyes | 3 (tre) |
| g. | Mekanik | 2 (dy) |
| h. | Saldator dhe prerës të metaleve | 1(një) |
| i. | Murator | 3 (tre) |
| j. | Pllakashtrues | 3 (tre) |
| k. | Hidroizolues | 3 (tre) |
| l. | Suvatues | 3 (tre) |
| m. | Bojaxhi | 2 (dy) |
| n. | Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse | 2 (dy) |
| o. | Punëtore ndërtimi te thjeshte | 30 (tridhjetë) |

Punonjës Manovrator

| | | |
|---|---|---|
| p. | Eskavatorist | 2 (dy) |
| q. | Automakinist | 2 (dy) |

r. Bultozierist 2 (dy)

*Për keta punonjes, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- *kontratën individuale të punës;*
- *një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.*
- *certifikatë te sigurimit teknik e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.*

*Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:*

- *Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).*
- *Për punonjesit Manovratoret duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor. Kerkesa per deshmite e manovratoreve bazohet ne Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi I përdorimit të makinerive të ndërtimit"*
  *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).*
- *Për punonjesit e krahut , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme.*

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

| Nr. | Emër Mbiemër i punonjësit | Profesioni | Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës | Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| etj | | | | |

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "ç". Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e*

*stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr.15/2017 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në "regjistrat profesionale" të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit te punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, ne mbështetje te Manualit te ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne katër elementet e strukturës se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore.*

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht <u>84 (tetëdhjetë e katër)</u> persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për një periudhe <u>3 mujore</u> nga data e zhvillimit te tenderit.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet te dorëzojë dokumentacionin si me poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

**Argumentimi**: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre "(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit. Komisioni i perllogaritjes se vleres se fondit limit dhe pergatitjes se dosjes teknike kane analizuar dhe perllogaritur numrin minimal te punetorise prej <u>84</u> punonjesish mesatarisht te dosmosdoshem per realizimin e objektit te prokurimit ne nje afat kohor <u>16 muaj - grafik punimesh</u>.*

**1.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, <u>mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</u>

| Mjetet | Sasia | Gjendja |
|---|---|---|
| Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton | 3 copë | Në pronësi ose me qira |
| Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 6 ton | 2 copë | Në pronësi ose me qira |

| | | |
|---|---|---|
| Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5ton | 3 copë | Në pronësi ose me qira |
| Kamion me vinxh me kapacitet mbajtes mbi 8 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Vinc kulle me kapacitet mbajtes jo me pak se 3 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Vinc karel portativ i levizshem me kapacitet mbajtes se 0.3-0.5 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Kamion me kosh per punime ne lartesi | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Trajler per transport mjetesh | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Fadromë me goma | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Ekskavator 0.25 $m^3$ me gome | 1copë | Në pronësi ose me qira |
| Ekskavator me zinxhirë | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Minieskskavator me zinxhirë | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Mini Fadromë | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Autobot uji | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Autobetoniere Kantieri 2.5$m^3$ | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Betoniere kantieri 0.25$m^3$ | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Autobetoniere me kapacitet mbi 6$m^3$ | 4 copë | Në pronësi ose me qira |
| Autopompë betoni | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Vibrator betoni | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Pompe Suvatimi | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Elektrosaldatriçe | 1copë | Në pronësi ose me qira |
| Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra) | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Vibrator betoni | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Moto pompe uji | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Motogjenerator | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Matrapik | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Rul vibrimi min 5 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Tokmak /paisje per nivelim shtresash | 2 copë | Në pronësi ose me qira |
| Armatur druri (Betoforma ) | 500 m2 | Në pronësi ose me qira |
| Skeleri + Rrjet plastike per mbrojte ne pune | 1000m2 | Ne pronesi ose me qira |
| Sonde shpimi me diameter ÷1000mm | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Gazogjen | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Makineri per saldim tubash ppr me elektrofuzion | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Makineri per saldim tubash polietileni | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| Kontenier Stacionar | 1 copë | Në pronësi ose me qira |
| GPS/ Total Station /Teodoliti, kerkohet per dhenien dhe kontrollin sa me te shpeshte te kuotave gjate procesit te punes ne kantier. | 1 copë | Në pronësi ose me qira |

*Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:*
*- certifikatën e pronësisë;*

*- lejen e qarkullimit;*
*- certifikatën e kontrollit teknik;*
*- siguracionin;*
*- certifikatë transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot përkatëse;*
*ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
*- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
*- kontrata e qirasë e cila duhet te përfshijë objektin përkatës dhe duhet te jete e vlefshme për te gjithë periudhën e realizimit te punimeve deri ne përfundimin e plote te punimeve.*
*- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
*- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, nuk janë te angazhuara ne procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do te jene te angazhuara vetëm ne këtë kontrate. Autoriteti Kontraktor gëzon te drejtën te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjate vlerësimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontratës.*

**Argumentimi**: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
*Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr.629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr.631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".*

### 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

a. ISO 9001 : 2015 -*"Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë",* e vlefshme, ose ekuivalente
b. ISO 45001:2018 - *"Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendet e Punës",* e vlefshme, ose ekuivalente.
c. ISO 14001:2015 -"*Sistemet e Menaxhimit të Ambientit*" e vlefshme, ose ekuivalente.
d. ISO 50001:2018 -*"Standard për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë",* e vlefshme, ose ekuivalente.

*Të gjitha certifikata e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
*Çertifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.*

*Ne zbatim të nenit 44 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion."*
*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Argumentimi**: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**2.4.2** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë i pajisur me liçencë lëshuar nga QKL:
- "Kodi III.2.B", "Për grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme",

së bashku me aktin e miratimit te tyre në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar

**Argumentimi**: *Operatori ekonomik duhet te disponoje leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim te mbetjeve qe kane ndikim ne mjedis Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu,), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, prishje (mur tulle, shtresa etj.), dhe kryerjen e transportit të tyre në vend depozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme".*

**2.4.3** Për listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:
- Pajisje hidrosanitare
- Pajisje elektrike
- Pajisje ngrohje-ventilim
- Pajisje ashensori

*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori ose marveshje bashkepunimi me prodhuesin/distributor i autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatat e cilesise ISO 9001:2015 të prodhuesit/ve ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara ne Specifikimet teknike.*

**Argumentimi**: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknikë, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontrates.*
*Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.*

### 2.4.4 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: "a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;"*

Grupi i hartimit te specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**,** vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por, edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

## Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",* **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance**, **apo/dhe çdo standard të kërkuar,** *ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*
*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

**Shënim:** *Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi "Cilësia e parë, Importi" ose "Cilësi e I-rë", ky përcaktim është i barazvlefshëm me termin " ose ekuivalentë". Në çdo kërkesë te preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohen fjalët "ekuivalente e saj".*

*Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhtme:

### 1. Emri dhe adresa e autoritetit pergjegjës

| | |
|---|---|
| Emri | Bashkia Durrës |
| Adresa | Sheshi "Liria", Qyteti Durrës |
| Tel/Fax | 052 22 23 10 |
| E-mail | info@durres.gov.al |

Faqja e Internetit www.durres.gov.al

**2. Lloji i procedurës se prokurimit:** Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit).

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** "Ndërtim shkolla 9-vjeçare Vadardh, Sukth".

**4. Numri i referencës së procedurës/**lotit**:** REF-27178-10-30-2024

**5. Fondi / vlera e përafërt e kontratës**: 268.788.521,53 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e një presje pesëdhjetë e tre) Lek pa TVSH.

**6**. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin**: 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj.

7. **Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data**:** **11.11.2024** **Ora: 10:oo**
Vendi: Prokurim elektronik www.app.gov.al

**8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data**:** **11.11.2024** **Ora: 10:oo**
Vendi: Prokurim elektronik www.app.gov.al

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit te gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

**Njësia e Prokurimit**